

## VENDIM

Nr. 645, datë 27.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.238, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E DHËNIES SË LEJES PËR LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË DHE HIPODROMET", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6,13,15 e 24 të ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në vendimin nr.238, datë 13.4.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në vendim fjalët "ËMinistri i FinancaveË" zëvendësohen me "Ëministri përgjegjës për ekonominëË", fjalët "ËMinistria e FinancaveË" zëvendësohen me "Ëministria përgjegjëse për ekonominëË" dhe fjalët "Komisioni i vlerësimit të kërkesaveË" zëvendësohen me "Komiteti i Lojërave të Fatit, për KazinotëË".

2. Në kapitullin I, në pikën 1, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "b", pas fjalëve "Ëthemeluesit e shoqërisëË" shtohet "ËaksionarëtË".

b) Në shkronjën "d" emërtimi "Instituti i Metrologjisë" zëvendësohet me "Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit".

3. Në kapitullin II bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në fund të shkronjës "a" të pikës 2 të nënndarjes "A", pas fjalëve "Ëaktin e themelimit të shoqërisëË" shtohen "Ëdhe aksionarët kryesorë zotërues të paketës kontrolluese të aksioneve të shoqërisëË".

b) Në shkronjën "dh", të nënndarjes "B", pas fjalëve "Ëmarrëveshje paraprakeË" shtohet "Ëtë paktëË".

c) Pas shkronjës "dh" të nënndarjes "B", shtohet shkronja "e" me këtë përmbajtje:

"e) Brenda 5 ditëve pune, pas përfundimit të procedurave të konkurrimit, subjekti i renditur i pari nënshkruan kontratën e angazhimit, me anë të së cilës merr përsipër përmbushjen e të gjitha angazhimeve të deklaruara në ofertën e tij, si dhe angazhimin për vazhdimin e procedurave të mëtejshme, deri në dhënien e kësaj lejeje. Refuzimi i nënshkrimit të kësaj kontrate ose moszbatimi i saj përbën shkak për skualifikimin e subjektit të renditur i pari dhe vazhdimin e procedurave të mësipërme me subjektin pasardhës apo për revokimin e lejes së dhënë."

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha